



**INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË
PUBLIKE TË KOSOVËS**


**NATIONAL INSTITUTE OF PUBLIC HEALTH
OF KOSOVA**



**SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCË, COVID-19 DHE
PATOGENËT TJERË RESPIRATORË NË KOSOVË,
SEZONA 2025/2026 (JAVA 40-TË)**

Simptomet e Gripit përfshijnë:

- Temperaturë/ethe
- Kokëdhimbje
- Lodhje
- Kollë e thatë
- Dhimbje fytë
- Rrjedhje hundësh
- Dhimbje muskulare
- Simptome gastrointestinale, si nauze dhe barkqitje




PËRMBLEDHJE

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike gjatë tërë vitit bën mbikëqyrjen permanente të Influcencës sezonale (ILI), ARI dhe SARI me intensifikim të aktiviteteve gjatë sezonës përkatëse. Mbikëqyrja realizohet përmes hulumtimit aktiv dhe pasiv në institucione shëndetësore dhe terren.

**SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCËN SEZONALE NË KOSOVË,
2021/2022 - 2025/2026**

Sipas grafikonit 1, ku janë paraqitur rastet e Influcencës sezonale (ILI) në 5 sezonat e fundit shohim se sezona 2025/2026 karakterizohet fillim të qarkullimit të virusit të Influcencë A që nga java e 40 të sezonës 2025/2026 (Graf.1).

Grafikoni.1



SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCËN SEZONALE NË KOSOVË, 2025/2026 DHE PRAGU EPIDEMIK


Nga fillimi i sezonës, 29 shtator 2025 deri më 5 tetor 2025 (java e 40-të) në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës janë raportuar 992 raste të Sëmundjes të ngjashme me Grip (ILI), 263 raste të Infeksioneve respiratore akute (ARI) dhe 0 raste me Infeksion të rëndë respirator akut (SARI).

Gjatë javës së 40-të (29.09.2025-05.10.2025) janë raportuar 992 raste ILI (Sëmundje e Ngjashme me Gripin), 263 raste ARI (Infeksion Respirator Akut) dhe asnjë rast me SARI (Infeksion i Rëndë Akut Respirator).

Përmes sistemit të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse dhe paralajmërimit të hershëm (SMSN) janë raportuar 283 raste ILI dhe 6 raste ARI.


Intensiteti i Influcencës sezonale sipas numrit të rasteve të raportuara për javën e 40-të paraqitet në aktivitetin e ulët të qarkullimit. (Graf.2)


Grafikoni.2



Në grafikoni 3 shohim se në të gjitha komunat janë raportuar raste të dyshimta në Influençë dhe sipas numrit të rasteve të raportuara, numër më të lartë kanë komuna e Prishtinës, Prizrenit dhe Pejës ndërsa sipas Incidencës numër më të lartë të rasteve kanë komuna e Kamenicë, Obiliqit dhe Suharekës. (Graf.3).


Grafikoni.3





Në raport me distribuimin e rasteve sipas grup-moshës dhe incidencës, nga numri total i rasteve të raportuara me ILI, shihet se të gjitha grup-moshat janë të atakuara derisa sipas Incidencës; grup-mosha 0-4 dhe mbi 65 vjeç (Graph.4). Sa i përket rasteve me ARI, grup-mosha më e atakuar është 0-4 vjeç (146 raste) pastaj grup-mosha 15-64 vjeç (47 raste), 5-14 vjeç (43 raste) dhe grup-mosha 65+ vjeç (27 raste). (Graf.4)

Grafikoni.4




MBIKËQYRJA VIROLOGJIKE

Në laboratorin e Qendrës Kombëtare të Influcencës – IKSHPK nga fillimi i sezonës 2025/2026 deri me 8 tetor 2025, janë testuar gjithsej 143 mostra nga pacientët e qendrave sentinel dhe jo sentinel si raste të dyshimta në ILI, ARI dhe SARI. Nga mostrat e testuara 72 (50.34%) prej tyre të dyshimta në SARS-CoV-2 dhe 71 (49.65%) të dyshimta në Influcencë dhe patogjenët tjerë respiratorë. Gjatë kësaj periudhe në SARS-CoV-2 janë konfirmuar 5 raste (6.9%). Nga 71 mostrat e testuara në Influcencë dhe patogjenët tjerë respiratorë është konfirmuar 1 rast me Influcencë A (pozitiviteti 1.4 %). Rasti i konfirmuar me Influcencë A është nga komuna e Prishtinës dhe i takon grup-moshës 5-14 vjeç. Gjatë javës së katërdhjetë (29.09.2025-05.10.2025), nga laboratorët private janë raportuar gjithsej 89 mostra të testuara si të dyshimta në SARS-CoV-2. Nga këto mostra nuk është konfirmuar asnjë rast pozitiv. Nga patogjenët tjerë respiratorë, janë konfirmuar: 2 mostra me RSV, 18 mostra me Human Rhinovirus, 7 mostra me Human Adenovirus dhe 3 mostra me Parainfluenza Virus.

Të dy rastet pozitive në RSV (2.81%), janë nga komuna e Prishtinës dhe i takojnë grup-moshës 0-4 vjeç.

Grafikoni.5



AKTIVITETET SEZONALE

IKSHPK/Departamenti i Epidemiologjisë bënë mbikëqyrjen e Influcencës gjatë tërë vitit, me intensifikim të saj gjatë sezonës përkatëse (java e 40 deri në javën e 20).

Përcjell situatën epidemiologjike me rastet ILI/ARI (javore) dhe rastet me SARI (në bazë ditore/alerti).

Bënë testimin laboratorik të mostrave në Departamentin e Mikrobiologjisë/Qendrën Kombëtare për Testimin e Influcencës.

Instituti Kombëtar ka apeluar te të gjithë Drejtorët Rajonal të Shëndetësisë Publike dhe punëtorët shëndetësor që të ngrisin nivelin e vigjilencës dhe raportimit të rasteve të dyshimta në të gjitha institucionet shëndetësore publike dhe private në Kosovë.

Ka rekomanduar tek Inspektorati shëndetësor të mbikëqyrë të gjitha Institucionet shëndetësore të Kosovës, për të urdhëruar për obligimin ligjor të paraqitjes së sëmundjeve ngjitëse dhe rasteve të vdekjeve nga këto sëmundje.

Ka dhënë këshilla për popullatën për mbrojtjen nga sëmundja dhe njohjen e simptomeve të saj.

MASAT PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË VIRUSIT TË GRIPIT SEZONAL

Aktiviteti i gripit për sezonën 2025/2026, është në nivel më të lartë krahasuar me sezonën paraprake dhe masat për parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve respiratore janë:

Mbajtja e maskave.

Distanca fizike.

Higjiena e duarve.

Evitimi i kontakteve të afërta me individë të sëmurë.

Redukimi i vizitave të familjarëve tek personat e hospitalizuar (SHSKUK, Spitalet rajonale).

Evitimi i vendeve të mbyllura dhe të mbingarkuara me njerëz.

Ushqimi i shëndetshëm me shumë vitamina.

Aktiviteti fizik dhe gjumë i mjaftueshëm.

Personat e sëmurë të qëndrojnë në shtëpi.

- Pastrimi dhe dezinfektimi i mjediseve ku qëndroni.
- Mbulimi i hundës dhe gojës me një shami gjatë teshtitjes dhe kollitjes si dhe hudhja më pas në vend të sigurt.
- Larja e duarve shpesh me ujë dhe sapun, ose solucione duarsh me alkool.
- Sytë, hunda dhe goja të mos preket me duar të kontaminuar, pasi virusi përhapet në këtë mënyrë.
- Pastrimi dhe dezinfektimi i sipërfaqeve dhe objekteve që mund të jenë kontaminuar nga virusi.

Konsultimi me mjekun për mjekimin me barna kundër gripit, të cilat duhet të merren vetëm me rekomandimin e mjekut

Medikamentet kundër gripit duhet të fillohen brenda 48 orëve të para të fillimit të sëmundjes për të pasur efektivitet të lartë.

Ato mund të parandalojnë edhe komplikimet e rënda që mund të vijnë nga gripit.

Mënyra më efikase për parandalimin e virusit të gripit është Vaksinimi me vaksinën kundër gripit.

- Vaksinimi mbron vetë personin dhe ndihmon në parandalimin e përhapjes së gripit.
- Efekti i vaksinës fillon 1 deri 2 javë pas marrjes dhe mbrojtja vazhdon rreth një vit pas vaksinimit.

VAKSINIMI

Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me IKSHPK në fillim të sezonës së gripit 2025/2026 ka siguruar 85,000 doza të vaksinës sezonale) dhe me fillimin e sezonës ka filluar vaksinimi sipas rekomandimeve.

HOSPITALIZIMET

Gjatë javës së fundit nga rastet e hospitalizuara në Klinikën Infektive, Klinikën e Pediatrisë dhe spitalet rajonale janë raportuar 28 raste me ARI dhe 1 rast me ILI.

SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE NË RAJON DHE EVROPË

INFLUENCA SEZONALE JAVA 40/2025 NË EVROPË

Në javën 39 të vitit 2025, pesë nga 24 shtetet dhe territoret e Rajonit Evropian të OBSH-së që raportuan të dhëna, kanë shënuar shkallë të rritura të sëmundjeve të ngjashme me gripin (ILI) dhe/ose infeksioneve akute respiratore (ARI) mbi nivelin bazë.

Aktiviteti i viruseve të gripit dhe RSV-së (Respiratory Syncytial Virus) vazhdon të jetë në nivel ndërsezonal në tërë rajonin.

Treguesit e aktivitetit të SARS-CoV-2 paraqiten të ndryshëm mes vendeve, por në nivel rajonal, përqindja e mostrave pozitive dhe numri i rasteve në kujdesin primar dhe sekondar janë stabilizuar ose kanë shënuar tendencë në ulje. Varianti XFG mbetet varianti dominues i SARS-CoV-2 në rajon. Shkallë të rritura të ILI janë raportuar në Turqi, ndërsa për ARI janë raportuar në Estoni, Lituani, Federatën Ruse dhe Spanjë. Nga të gjitha mostrat e marra nga qendrat sentinel për ILI dhe ARI, përqindja e mostrave pozitive ishte si vijon:

- Gripi: 3% (pa ndryshim nga java e kaluar) – nën pragun epidemik prej 10%. Shkalla mesatare e pozitivitetit për 19 vende ishte 0% (interval 0–6%) dhe asnjë vend nuk raportoi $\geq 10\%$.
- SARS-CoV-2: 17%, në rënie nga 21% javën paraprake. Shkalla mesatare e pozitivitetit në 18 vende ishte 15% (interval 0–54%).
- RSV: 0%, njëjtë si java paraprake; shkallë pozitiviteti 0% (interval 0–1%).

Nga 51 mostra të raportuara për grip me tip të përcaktuar nga qendrat sentinel, të gjitha ishin të tipit A, dhe nga 31 të nëntipizuara: 71% ishin A(H1)pdm09 dhe 29% ishin A(H3).

Nga 25 vende që raportuan intensitetin e gripit, asnjë nuk raportoi intensitet mesatar apo të lartë. Po ashtu, nga 24 vende që raportuan shpërndarjen gjeografike, asnjë nuk raportoi përhapje rajonale apo të gjerë. Nga të gjitha mostrat e marra nga qendrat sentinel për SARI (Severe Acute Respiratory Infection):

- Gripi: 2%, njëjtë me javën paraprake. Nga 9 vende raportuese, shkalla e pozitivitetit ishte 0% (interval 0–13%). Në total u raportuan 19 raste pozitive për virusin e gripit, kryesisht të tipit A; nga 6 të nëntipizuara, 4 ishin A(H1)pdm09 dhe 2 A(H3).

- SARS-CoV-2: 11%, në ulje nga 13% një javë më parë; shkallë pozitiviteti 7% (interval 0–31%).
- RSV: 0%, pa ndryshim; shkallë pozitiviteti 0% (interval 0–2%).

Shkalla e vdekjeve nga COVID-19 mbetet e ulët në mesin e 41 vendeve që raportuan të dhëna. Sipas sistemit EuroMOMO, vdekshmëria totale për të gjitha shkaqet në 26 vende pjesëmarrëse është brenda kufijve të pritur në të gjitha grupmoshat. Që nga java 40/2024, aktiviteti i gripit është dominuar nga nën-tipi A(H1)pdm09, si nga qendrat sentinel ashtu edhe në atë jo-sentinel.

Në tërësi, aktiviteti i viruseve respiratore në Rajonin Evropian të OBSH-së mbetet në nivele ndër-sezonale, me qarkullim të kufizuar të viruseve të gripit dhe tendencë të stabilizuar të SARS-CoV-2. Situata epidemiologjike nuk tregon shenja të një sezoni të hershëm të gripit, megjithatë mbetet i nevojshëm monitorimi i vazhdueshëm i tendencave dhe i ndryshimeve të mundshme në qarkullimin viral.

Burimi: <https://erviss.org/>